



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VLORË

Nr. _____ prot.

Vlorë, më _____ 2018

VENDIM

Nr. 129 Datë, 6.12. 2018

**“Për Miratimin e Programit të Transparencës
të Bashkisë Vlorë”**

Bazuar në Ligjin Nr,139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 3, neni 8, neni 9/1 pika 1/1, a,b, neni 12 pika 2, nenet 15,16,19,20, neni 54 pika k, Ligjit nr.119/2014 datë 18.09.2014 ‘Për të drejtën e informimit’, Ligjit nr, 146/2014, datë 30.10.2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, Urdhërit nr, 211, datë 10.09.2018 të Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, “Për Miratimin e Programit Model të Trasparencës për Njësitë e Qeverisjes Vendore” si dhe në Relacionin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbledhjen e datës

VENDOSI:

1. Të miratojë Programin e Trasparencës të Bashkisë Vlorë sipas Tabelës Përmbledhëse , bashkalidhur këtij Projekt Vendimi.
2. Brenda 10 ditëve nga shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut Vlorë, Programi i transparencës të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi bazuar në Ligjin nr, 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 55 pika 6.

KRYETARI

Vojsava Shkurtaj